



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

KONKURS

Për përzgjedhjen e anëtarit në Këshillin Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare nga Organizatat Jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

Bazuar në nenin 36 të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 3 dhe 4 të Rregullores MD – nr. 08/2024 për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare, ftohen profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare nga Organizatat Jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare të aplikojnë për përzgjedhje për anëtar në Këshillin Profesional të Shërbimeve Sociale dhe Familjare (KPSHSF).

Obligimet, përgjegjësitë e KPSHSF-së dhe kohëzgjatja e mandatit:

- Licencon ofruesit individual për shërbime sociale dhe familjare;
- Këshillon Ministrin në përcaktimin e prioritetëve të Ministrisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Zhvillon programe për trajnimin për ofrues individual të shërbime sociale dhe familjare.
- Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të KPSHSF është katër (4) vjet.

Kriteret për aplikim:

- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbime sociale dhe familjare;
- Të jetë i licencuar në nivelin profesional.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa për aplikim;
- CV-ja;
- Fotokopja e letërnjoftimit;
- Fotokopja e diplomës (kopje e noterizuar);
- Vërtetimin mbi përvojën e punës (origjinale - kopje e noterizuar);
- Kopja e licencës (niveli profesional);
- Referenca (origjinale - kopje e noterizuar);
- Dëshmia nga gjykata (origjinale - kopje e noterizuar);

Afati dhe adresa për aplikim:

Paraqitja e kërkesave për konkurim në këtë Këshill do të zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të kësaj ftese publike, përkatësisht nga data 06.09.2024 deri më datën 20.09.2024.

Profesionistët e interesuar, kërkesën me dokumentet e nevojshme për aplikim mund t'i dërgojnë përmes postes elektronike në këtë e-mail adresë: ylber.kokollari@rks-gov.net.

Për çdo informatë shtesë mund të kontaktoni në këta numra telefoni: 038 200 67 454.